

Deputetët Mbështesin Normalizimin

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi më 3 dhjetor 2021, në Brezovicë, Kosovë, tryezën e rrumbullakët të radhës për deputetë aktualë dhe ish-deputetë të parlamenteve të Serbisë dhe Kosovës. Pjesëmarrësit diskutuan se si deputetët mund të mbështesin dialogun dhe të parandalojnë incidentet. Tryeza është pjesë e një projekti më të madh për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i financuar dhe zbatuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës (FDFA). Raporti nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet individuale të pjesëmarrësve, CIG, ose FDFA, por pasqyron diskutimin në tërësi.

Rekomandimet dhe Konkluzionet

- **Udhëheqësit politikë duhet ta shohin ‘marrëveshjen e paqes’ si pjesë të trashëgimisë së tyre.** Një ‘trashëgimi politike’ e mirë për momentin nuk duket të jetë e rëndësishme për liderët politikë. Ata janë kryesisht të fokusuar në fitoren e zgjedhjeve. Megjithatë, ata duhet të marrin parasysh ‘trashëgiminë’ e tyre kur negociojnë. Për të arritur një marrëveshje, ata duhet të fillojnë fillimisht me “zbutjen” e narrativës së vendosur. Një narrativë e re duhet të theksojë se serbët dhe shqiptarët mund të jenë një burim i dobishëm për njëri-tjetrin, jo një kërcënim. Serbia dhe Kosova mund të fillojnë ta shohin njëra-tjetrën si partnerë të mundshëm, jo si armiq të përhershëm. Diskursi duhet të fokusohet më shumë në bashkëpunimin ekonomik dhe social, dhe më pak në çështjet etnike dhe territoriale. Shumë folës ishin optimistë për një marrëveshje normalizimi.
- **Kosova dhe Serbia duhet ta shohin dialogun e Brukselit si mundësi, jo si barrë.** Të dyja palët e shohin dialogun si proces me më shumë rreziqe sesa si mundësi. Ata duhet të ndryshojnë këtë mendim dhe ta shohin dialogun si një mundësi. Dhe kjo është përgjegjësi e politikanëve. Liderët nuk duhet të përdorin “kundërshtimin e qytetarëve ndaj dialogut” si një justifikim për të mos ndërmarrë hapa më të guximshëm. Fokusi i dialogut duhet gjithashtu të jetë më pak i fokusuar në “përmirësimin e së kaluarës dhe më shumë në përmirësimin e së ardhmes.” Serbia dhe Kosova kanë nevojë për “një marrëveshje për të ardhmen, jo për të kaluarën.” Palët duhet së pari të bien dakord për marrëdhëniet e tyre të ardhshme, e cila është një parakusht për të trajtuar të kaluarën në një mënyrë më racionale. Beogradi dhe Prishtina kanë këndvështrime të ndryshme për dialogun: derisa Beogradi e sheh atë si vazhdimësi të dialogut të vjetër, Prishtina e sheh atë si diçka që ka të bëjë vetëm me “njohje”. Palët duhet të përpiqen ndonjëherë ta shohin procesin me sytë e tjetrit. Përderisa është e pranueshme që të dyja palët përpiqen për të “fituar” maksimumin e kërkesave të tyre, ato gjithashtu duhet të mundohen ta kuptojnë pse pala tjetër dëshiron atë që dëshiron.

- **Palët duhet të punojnë për të krijuar një “logjikë të fitores së dyanshme” në dialog.** Një proces paqeje mund të ketë sukses vetëm nëse ka një logjikë të fitores së dyanshme. Palët duhet të shqyrtojnë se si të ndërtojnë një proces të bazuar në një logjikë të tillë, cilat janë kompromiset e nevojshme dhe cilat janë mundësitë për rezultate nga të cilat do të “fitonin” të dyja palët. Serbët dhe shqiptarët duhet të punojnë për të “kuptuar” dialogun në të njëjtën mënyrë. Një folës tha se ata nuk mund të parashikojnë elementet e marrëveshjes, por mund të punojnë për të. Narrativa për dialogun gjithashtu ka nevojë për disa modifikime: palët duhet të bien dakord për narrativën, pastaj ta koordinojnë dhe sinkronizojnë atë. Mesazhi duhet të jetë që dialogu nuk po “imponohet” tek palët, por që ato janë të interesuara që ky mekanizëm të zgjidhë mosmarrëveshjet e tyre. Ata duhet të kuptojnë perspektivën e njëri-tjetrit: Beogradi duhet të shohë pse Kosova ka nevojë për njohje, ndërsa Kosova duhet të shohë pse është e vështirë për Serbinë ta njohë atë dhe pse serbët e Kosovës kanë nevojë për të drejtat e tyre. Një folës tha se marrëveshja duhet të jetë ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe të mos lërë çështje të hapura. Edhe nëse marrëveshja nuk përfshin njohjen de jure, ajo do të kërkonte ndryshimin e kushtetutës së Serbisë. Por së pari, palët duhet të bien dakord për qëllimin e dialogut dhe më pas për një rrugë se si të arrihet atje. Qëllimi i procesit duhet të formulohet në atë mënyrë që palët të bien dakord për një modalitet funksional të ekzistencës së dy subjekteve të pavarura, sugjeroi një pjesëmarrës. Një folës tjetër tha se palët mund të punojnë në shumë fusha jo të ndjeshme derisa të bëhet e mundur njohja. “Marrëveshjet më të vogla nuk duhet të jenë peng i marrëveshjes së madhe.”
- **Bashkëpunimi rajonal mund të ndihmojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe.** Një efekt anësor pozitiv i nismës ekonomike të Ballkanit të Hapur mund të jetë zgjidhja e një numri mosmarrëveshjesh dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallrave, tregtia dhe diploma, ndër të tjera. Nisma mund të shërbejë gjithashtu si një mjet për krijimin e perspektivave më të favorshme për sipërmarrësit dhe prodhuesit duke zgjeruar tregjet dhe mundësitë. Një folës tha se Marrëveshja e Wreashingtonit gjithashtu duhet të respektohet dhe të zbatohet nga qeveritë, pasi ajo do të përmirësonte marrëdhëniet ekonomike.
- **Dialogu dhe marrëveshjet duhet të bazohen në reciprocitet dhe barazi.** Një folës kosovar tha se marrëveshjet në Bruksel duhet të bazohen në barazi. “Kosova nuk duhet të jetë më e shënuar me fusnotë.” Shumë folës thanë se palët janë të barabarta në dialog, por Kosova ka ‘status të pabarabartë’ në forume të tjera, por se për këtë nuk është faji i Serbisë. “Nuk mund të fajësosh Serbinë pse Kosova nuk është në OKB.” Një folës tjetër tha se ka nevojë të qartësohet fakti se nga një marrëveshje eventuale do të përfitonin të dyja palët.
- **Rreziku për përshkallëzim do të jetë i pranishëm për sa kohë që problemi mbetet i pazgjidhur.** Serbët dhe shqiptarët duhet të bëjnë më shumë “promovim të paqes dhe më pak promovim të patriotizmit.” Situata mund të përshkallëzohet sepse mosmarrëveshjet janë të portretizuara si çështje të aspektit etnik. Një folës tha se palët duhet t’i trajtojnë problemet përpara se ato të kthehen në kriza, si çështja e targave të makinave, si dhe të zbatojnë atë për të cilat kanë rënë dakord. Moszbatimi ushqen mosbesim dhe dërgon mesazhin se marrëveshjet mund të mos zbatohen edhe kur të nënshkruhen dhe ratifikohen.
- **Mosbesimi nuk është pengesë, interesat kontradiktore janë.** Mosbesimi nuk është problem aq i madh në dialog, por interesat dhe qëllimet e ndryshme dhe shpesh kontradiktore janë.

Qëndrimi i Kosovës është se “ajo duhet të shkojë në tavolinë, të mbrojë pozicionin e saj dhe të bëjë më të mirën për të arritur qëllimet e saj.” Por Serbia ka synime të ndryshme. Një folës tha se “përderisa Kosova pret një marrëveshje të përqendruar në njohjen reciproke, Serbia pret një “pa njohje.” Përafrimi i këtyre pozicioneve është “pothuajse i pamundur.” Një folës tjetër tha se një marrëveshje gjithëpërfshirëse mund të vijë në faza, duke përfshirë njohjen nga Serbia në fazën përfundimtare, njohjen nga vendet e BE-së që nuk e njohin Kosovën dhe gjetjen e një modaliteti për Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe.

- **Kompromiset e nevojshme në çdo hap.** Çfarë është një kompromis? Duke marrë si shembull diskursin në tryezë, folësi tha se një kompromis do të ishte që pjesëmarrësit serbë “të mos përdorin termin Kosova dhe Metohija, por vetëm Kosovë, dhe pjesëmarrësit shqiptarë të mos përdorin termin Republika e Kosovës, por Kosova.” Ai shtoi se “Kosova nuk është pjesë e Serbisë, por një shtet që Serbia nuk e njeh.” Kompromisi është heqja dorë nga disa pozicione maksimaliste dhe gjetja e zgjidhjeve që janë të mira për të gjithë qytetarët. Një marrëveshje “pa njohje” mund të kapërcejë hendekun midis pozicioneve. Do të ishte një lloj historie si “fitore e dyanshme” ashtu edhe “humbje e dyanshme:” Kosova nuk do të merrte njohje, por “do të zhbllokonte integrimin e saj të ardhshëm në komunitetin ndërkombëtar, ndërsa Serbia do të duhej ta hiqte Kosovën nga kushtetuta e saj, por nuk do të duhej të jepte një njohje diplomatike.” “Fitorja e dyanshme” do të thotë se edhe Kosova edhe Serbia do të lëviznin më shpejt drejt BE-së. Sidoqoftë, pyetja më e madhe është nëse palët duan një marrëveshje! Nëse e bëjnë këtë, ata do të jenë fleksibil me pozicionet e tyre maksimaliste. Nëse jo, palët do të mbajnë qëndrimet e tyre maksimaliste dhe do të vazhdojnë të bllokojnë negociatat. Përfitimet praktike për Serbinë do të ishin përshpejtimi i integritetit të saj në BE, rritja e tregtisë me Kosovën dhe futja e Kosovës në Ballkanin e Hapur. Përfitimet praktike për Kosovën do të ishin liberalizimi i vizave, njohjet e reja dhe njohjet nga katër anëtarët e NATO-s që aktualisht nuk e njohin Kosovën. Sidoqoftë, duket se “konflikti i ngrirë është i ‘favorshëm’ për liderët e Serbisë dhe Kosovës.”
- **Zgjidhja e problemeve përpara se ato të përshkallëzohen.** Ka pasur progres thelbësor në dialog në fillim, palët arritën një sërë marrëveshjesh dhe ka pasur pritshmëri që do të ketë edhe marrëveshje përfundimtare. Ka pasur më pak hezitim nga palët sesa tani. Prishtina nuk është dashur të dërgojë policinë në veri për targa të veturave. A e bëri këtë vetëm për fushatën zgjedhore? Nëse po, atëherë pati efekt të kundërt, tha një folës. Palët duhet të bisedojnë, qoftë edhe pa agjendë, vetëm për të relaksuar marrëdhëniet e tyre. Marrëdhëniet më miqësore prodhojnë mundësi, duke e bërë më të lehtë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Palët kanë nevojë për një komunikim më të mirë, ndoshta për të krijuar një ‘hotline’ mes qeverive. Një folës tha se Lista Serbe mund të shërbejë si “urë lidhëse” midis Beogradit dhe Prishtinës. Problemet duhet të zgjidhen “në tavolinë, jo në rrugë.” Folësi gjithashtu sugjeroi më shumë vizita zyrtare dypalëshe mes zyrtarëve të Kosovës dhe Serbisë.

Shumë folës thanë se shoqëritë dëshirojnë stabilitet dhe për këtë arsye do të mbështesnin arritjen e një marrëveshjeje. Kur politikanët thonë se shoqëritë janë kundër marrëveshjes, ky është thjesht justifikimi i tyre “për të mos bërë asgjë”. Folësi tha se qëllimi i menjëhershëm i dialogut duhet të jetë “relaksimi i marrëdhënieve mes dy subjekteve.” Ata e kuptuan se është arritur shumë në vitet e fundit, edhe pse kjo arritje mund të mos jetë e kënaqshme. Shumë sugjeruan se Prishtina dhe

Beogradi duhet t'i adresojnë mosmarrëveshjet e tyre më shumë me "terma demokratikë" sesa me "terma etnikë".

Pjesëmarrësit

Sipas rendit alfabetik

Gresa Baftiu, Bashkëpunore në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Balsa Bozovic, Ish-deputet i Parlamentit të Serbisë

Sadri Ferati, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

Dubravka Filipovski, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe

Shpetim Gashi, Nënkyetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Dukagjin Gorani, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës

Dalibor Jevtic, Nënkyetar, Lista Serbe

Dubravka Kralj, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

Pauline Menthonnex, Zëvendësambasadore, Ambasada e Zvicrës në Kosovës

Ljubisa Mijacic, Analist

Besian Mustafa, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

Igor Novakovic, Bashkëpunor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Zoran Ostojic, Ish-deputet i Parlamentit të Serbisë

Zenun Pajaziti, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës, Anëtar i Kryesisë, Partia Demokratike e Kosovës

Snezana Paunovic, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë

Nenad Radosavljevic, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës

Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Xhelal Svecla, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës, Ministër i Punëve të Brendshme të Kosovës

Visar Ymeri, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës